



ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS  
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA  
KOSOVA BAR ASSOCIATION

Bazuar në nenin 41 të Ligjit për Odën e Avokatëve të Kosovës dhe nenit 83 të Statutit të Odës së Avokatëve të Kosovës, Këshilli Drejtues i Odës së Avokatëve të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30/06/2016, miraton:

## **Rregullore për caktimin e avokatëve sipas detyrës zyrtare dhe ofrimin e ndihmës juridike falas**

### **Kapitulli I Dispozitat e përgjithshme**

#### **Neni 1 Qëllimi**

Përmes kësaj rregullore, Oda e Avokatëve të Kosovës (këtu e tutje "OAK"), përcakton procedurat, rregullat dhe kriteret, të drejtat dhe detyrimet e avokatëve të caktuar në rastet e përfaqësimit sipas detyrës zyrtare në çështjet penale, në Polici, Prokurori, Gjykata në Kosovë dhe ndihmës juridike falas në Agjensionin e ndihmës juridike falas (më tutje "ANJF").

#### **Neni 2 Fushëveprimi i Rregullores**

Dispozitat e kësaj rregullore janë të zbatueshme për të gjithë avokatët e regjistruar në regjistrin e Avokatëve që janë të gatshëm të jenë pjesë e listës së avokatëve të cilët do të ofrojnë shërbime sa i përket caktimit të rasteve sipas detyrës zyrtare në Polici, Prokurori, Gjykatave dhe ndihmës juridike falas në ANJF, në bazë të kushteve të përcaktuara në këtë rregullore.

### **Kapitulli II Themelimi i Zyrës Koordinuese brenda Administratës së OAK për rastet e caktimit të avokatëve sipas detyrës zyrtare dhe ndihmës juridike falas**

#### **Neni 3 Zyra Koordinuese**

1. OAK do të themelojë Zyrën Koordinuese brenda Administratës së OAK, përgjegjëse

për koordinimin e aktiviteteve mes OAK, Gjykatave, Prokurorive, Policisë dhe ANJF në caktimin e avokatëve në rastet për përfaqësimin sipas detyrës zyrtare dhe ofrimin e ndihmës juridike falas.

2. Zyra Koordinuese do të jetë funksionale gjatë 24 orëve dhe do të adresoj të gjitha kërkesat e marra nga Gjykatat, Prokuroritë, Policia dhe ANJF për caktimin e avokatit në rastet e përfaqësimit sipas detyrës zyrtare dhe ofrimin e ndihmës juridike falas, zëvendësimin e avokatëve në rastet e caktuara, duke u bazuar në procedurat dhe rregullat e parashikuara në këtë Rregullore.

3. OAK do të sigurojë që Zyra Koordinuese do të ketë personelin e nevojshëm, për të ushtruar funksionet e saj në përputhje me këtë Rregullore.

4. Zyra Koordinuese do t'i raportojë drejtpërdrejt Drejtorit Ekzekutiv të OAK.

5. Zyra Koordinuese do të krijojë dhe mirëmbajë bazën e të dhënave në të cilën do të regjistrohet çdo rast kur caktohet avokati sipas detyrës zyrtare dhe në Agjensionin e ndihmës juridike falas, datën dhe kohën kur çështja i është caktuar, duke përfshirë të gjitha veprimet e tjera të marra nga avokati në lidhje me atë rast.

6. Avokatët obligohen për njoftimin e zyrës koordinuese për pjesëmarrje në seancat në proces, me qëllim të evidentimit në bazën e të dhënave.

#### **Neni 4**

##### **Lista për caktimin e avokatëve në rastet sipas detyrës zyrtare dhe ndihmës juridike falas**

1. Oda do të krijojë listën e avokatëve që do të caktohen për të përfaqësuar në rastet sipas detyrës zyrtare dhe në ofrimin e ndihmës juridike falas.

2. Zyra Koordinuese në bashkëpunim me Policinë, Prokurorinë, Gjykatën dhe ANJF, në përputhje me kushtet e përcaktuara në MeM e lidhur ndërmjet OAK me KGJK-në, KPK-në dhe Policinë e Kosovës, do të caktojë avokatët për të përfaqësuar të pandehurit në çështjet penale dhe në ofrimin e ndihmës juridike falas.

3. Avokatët përmes deklarimit të tyre do të shprehin interesin për të përfaqësuar sipas detyrës zyrtare në Polici, Prokurori, Gjykatë dhe ofrimin e ndihmës juridike falas në ANJF.

4. Listën e avokatëve për përfaqësimin në Polici, Prokurori, Gjykatë dhe ANJF e përbejnë të gjithë avokatët që janë deklaruar dhe shprehin interesim për të përfaqësuar sipas detyrës zyrtare dhe ofrimin e ndihmës juridike falas në ANJF.

5. Caktimi i avokatëve në rastet ex-officio dhe në ofrimin e ndihmës juridike falas;

- a) Të gjithë avokatët e deklaruar për përfaqësimin ex-officio, pa kategorizim/dallim do të përfaqësojnë rastet ex-officio në polici.
  - b) Të gjithë avokatët të cilët kanë përvojë më pak se tre vite si; avokatë, prokuror ose gjyqtar do të përfaqësojnë të pandehurit në të gjitha fazat e procedurës penale në çdo nivel të departamenteve të përgjithshme të prokurorive dhe gjykatave si dhe ofrimin e ndihmës juridike falas në ANJF. Në ANJF mund të përfaqësojnë edhe avokatët të cilët janë të deklaruar që të përfaqësojnë vetëm në lëndët civile.
  - c) Të gjithë avokatët të cilët kanë përvojë mbi tre vite si; avokatë, prokuror ose gjyqtar do të përfaqësojnë të pandehurit në të gjitha fazat e procedurës penale në çdo nivel të prokurorive dhe gjykatave, në Departamentin për të Mitur dhe Departamentet e Krimeve të Rënda.
  - d) Rastet nga pika (a) të këtij neni, për të cilat do të kërkohet përfaqësimi në Departamentet e Përgjithshme do të përcillen ose zëvendësohen me avokatët të cilët kanë përvojë pune juridike më pak se tre vite si; avokatë, prokuror ose gjyqtar.
  - e) Rastet nga pika (a) të këtij neni, për të cilat do të kërkohet përfaqësimi në Departamentet për Krime të Rënda ose në Departamentin për të Mitur do të përcillen ose zëvendësohen me avokatët të cilët kanë përvojë mbi tre vite si; avokatë, prokuror ose gjyqtar.
  - f) Avokatët e caktuar sipas pikës (a) të këtij neni janë të obliguar që të informojnë Zyrën Koordinuese lidhur me kualifikimin e veprave penale të përfaqësuara në Polici procedimin e rastit apo heqjes dorë nga përfaqësimi i mëtejshëm.
6. OAK do të dërgojë Listën e avokatëve tek ANJF së paku një herë në vit dhe do ta freskojë të njëjtën çdo dy muaj. Lista e dërguar nga OAK do të jetë e obligueshme për ANJF dhe zgjedhja e avokatëve do të bëhet sipas radhës.
  7. Listat e avokatëve të përgatitura nga OAK do të përditësohen çdo dy muaj ose si shihet e përshtatshme nga vetë OAK, ose me propozim nga Zyra Koordinuese.
  8. OAK do të koordinohet me KGJK-në, KPK-në, Ministrinë e Drejtësisë dhe institucionet tjera kompetente për të ngritur përfaqësimin e të pandehurve sipas detyrës zyrtare edhe në Departamentet e Përgjithshme të gjykatave dhe prokurorive, në rastet kur kërkohet interesi i drejtësisë (rastet kur dënimi me

burgim efektiv mund të shqiptohet me një vit burgim-praktika e gjykatës evropiane për të drejtat e njeriut përcakton se në çdo rast kur gjykata mund të shqiptoj dënim efektiv mbi një vit burgim duhet ti lejohet e drejta në avokat me shpenzime publike).

9. Avokatët do të caktohen për përfaqësim ex-officio edhe në ANJF vetëm në qytetin ku e kanë selinë e zyrës e përjashtimisht në mungesë të avokatëve edhe në qytetin më të afërt.
10. Në qytetet në të cilat në nivelet e gjykatave, prokurorive nuk ekziston Departamenti për të Mitur dhe Departamenti për Krime të Rënda, të gjithë avokatët e deklaruar për përfaqësimin ex-officio, do të angazhohen pa kategorizim.

### **Neni 5 Zëvendësimi i avokatit**

1. OAK, në parim mban politikën e saj që avokati i caktuar në përfaqësim sipas detyrës zyrtare dhe ndihmës juridike falas, do të përfaqësojë klientin gjatë të gjitha fazave të procedurës.
2. Avokati mund të zëvendësohet sipas kushteve të parapara me këtë rregullore dhe përjashtimisht, nëse plotësohen rrethanat e mëposhtme:
  1. Konfliktit të interesit;
  2. Kërkesës së justifikueshme të avokatit dhe klientit;
  3. Avokati për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme nuk është në gjendje për të përfaqësuar klientin në atë seance/rast; dhe
  4. Shkaqet tjera të përcaktuara me ligj dhe akte nënligjore
3. Zëvendësimi i avokatit në rastet e përfaqësimit sipas detyrës zyrtare duhet të bëhet në koordinim me Zyrën Koordinuese për caktimin e Avokatëve Ex-Officio.

### **Neni 6 Përfaqësimi ligjor Pro-Bono dhe Kontributi**

1. Avokatët të cilët përfaqësojnë sipas detyrës zyrtare dhe ndihmës juridike falas janë të obliguar brenda një viti kalendarik në së paku një (1) lëndë të ofrojnë shërbimet e tyre Pro Bono, në çështjet ligjore të paraqitura nga ANJF, Policia, Prokuroria apo Gjykata sipas kërkesës së këtyre institucioneve.
2. Caktimi i avokatit për ofrimin e ndihmës ligjore Pro Bono do të bëhet përmes Zyrës Koordinuese për caktimin e avokatëve ex-officio.
3. Të gjithë avokatët të cilët përfaqësojnë sipas detyrës zyrtare dhe ndihmës juridike

falas janë të detyruar të mbështesin OAK dhe Zyrën Koordinuese, me 2 % (dy për qind) të të ardhurave të tyre nga përfaqësimi sipas detyrës zyrtare dhe ofrimi i ndihmës juridike falas.

4. Kontributi i avokatit nga të ardhurat e tyre nga përfaqësimin sipas detyrës zyrtare dhe ndihmës juridike falas do të financojë dhe siguroj qëndrueshmërinë dhe funksionalitetin e Zyrës Koordinuese.

#### **Neni 7**

##### **Konflikti i interesit në caktimin e avokatëve sipas detyrës zyrtare**

1. Zyra Koordinuese dhe avokatët do të sigurohen që të shmangen nga çdo konflikt i interesit gjatë caktimit të avokatëve në rastet e përfaqësimit sipas detyrës zyrtare dhe ndihmës juridike falas.

2. Në të gjitha rastet kur avokati e kupton ose është i vetëdijshëm se ka konflikt interesi, duhet të informojë menjëherë Zyrën Koordinuese dhe do të kërkoj që të zëvendësohet në rastin e caktuar.

#### **Neni 8**

##### **Shpërblimi dhe kompensimi i shpenzimeve**

Avokatët, pagesën për angazhimet sipas detyrës zyrtare, mund t'ia realizojnë në gjykata prokurori apo në ANJF, vetëm pas marrjes së vërtetimit/konfirmimit me shkrim nga Zyra Koordinuese për caktimin e Avokatëve Ex-Officio, se angazhimi ka qenë konform kësaj Rregullore.

#### **Neni 9**

##### **Raportimi vjetor në lidhje me caktimin e avokatëve sipas detyrës zyrtare dhe ndihmës juridike falas**

1. Këshilli Drejtues i OAK do të diskutojë dhe miratojë draftin e raportit vjetor të dorëzuar nga Zyra Koordinuese përmes Drejtorit Ekzekutiv të OAK-së.
2. Raporti vjetor duhet të përfshijë veprimet dhe aktivitetet e marra nga OAK dhe mekanizmat e saj të brendshëm për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e bashkëpunimit mes OAK dhe institucioneve tjera lidhur me përfaqësimin sipas detyrës zyrtare dhe ndihmës juridike falas.
3. Një pjesë e raportit vjetor do të përfshijë edhe pyetësorët për vlerësimin e përfaqësimit sipas detyrës zyrtare dhe ndihmës juridike falas nga ana e avokatëve, të cilat plotësohen nga ana e prokurorëve, gjyqtarëve, klientëve dhe përfaqësuesve të ANJF.

### **Neni 10**

#### **Pyetësorët anonim për klientët, prokurorët, gjyqtarët dhe përfaqësuesit e ANJF në lidhje me performancën dhe cilësinë e përfaqësimit nga ana e avokatëve**

1. OAK do të organizojë anketa anonime me klientë, prokurorë, gjyqtarë dhe përfaqësues të ANJF në lidhje me performancën dhe cilësinë e përfaqësimit të avokatëve mbrojtës në raste sipas detyrës zyrtare dhe ndihmës juridike falas.
2. Anketat anonime do të realizohen në përputhje me format dhe pyetësorët e aprovuar nga OAK.

### **Neni 11**

#### **Hyrja në fuqi**

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues i OAK dhe fillon të zbatohet 30 ditë pas hyrjes në fuqi.
2. Neni 6 i kësaj rregullore hynë ne fuqi me 01 janar 2017.

**Av. Osman Havolli, Kryetar  
Oda e Avokatëve të Kosovës**